



UNITED NATIONS
ALBANIA



T'I JEPET FUND DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË SHQIPËRI

PARASHTRIM I POZICIONIT TË OKB-SË

3 DHJETOR 2024

Versioni i Plotë

T'i jepet fund dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri

Parashtrim i pozicionit të OKB-së¹

Objektivi dhe metodologjia

Ky dokument politikash synon të theksojë çështjen kritike të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Në fillim, ai identifikon format e shumta të dhunës me të cilën përballen këto gra dhe pengesat që hasin për të pasur akses në shërbime, bazuar në burime dhe të dhëna të ndryshme, ndër të cilat edhe rekomandimet e mekanizmave të drejtave të njeriut dhe studimet e kryera nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të). Pas kësaj, në dokument bëhet një përshkrim i kornizës ligjore ndërkombëtare në këtë fushë, në kuadër të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës, përfshirë jurisprudencën e organeve të tyre *quasi* gjyqësore ose gjyqësore. Në vijim pason një analizë e shkurtër e kuadrit ligjor kombëtar për identifikimin e mangësive të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje e menjëhershme sipas së legjislacionit ndërkombëtar të drejtave të njeriut. Dokumenti mbyllet me një numër rekomandimesh praktike për sigurimin e shërbimeve të përshtatshme për mbrojtjen dhe mbështetjen e grave me aftësi të kufizuara viktime të dhunës, të cilat u drejtohen aktorëve të ndryshëm, në veçanti aktorëve qeveritarë dhe OSHC-ve.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e analizës konsistoi kryesisht në studimin bibliografik të dokumenteve kryesore të kohëve të fundit për këtë çështje, ndër të cilat mund të përmendim raportet e të drejtave të njeriut për Shqipërinë, raporte të OSHC-ve që punojnë me gratë me aftësi të kufizuara, dhe dokumente të tjera të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të marra nga Grupi Tematik dhe i Rezultateve Gjinore (GTRGJ) i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Raporti i Aftësisë së Kufizuar dhe Zhvillimit 2024 u konsiderua gjithashtu si pjesë e dokumenteve kryesore të studiuara². Dokumenti u rishikua dhe miratua nga ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

Hyrje

Dhuna ndaj grave dhe vajzave është një shkelje mjaft e përhapur e të drejtave të njeriut dhe forma më e rëndë e manifestimit të diskriminimit gjinor, ku gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përballen me sfida të veçanta që thellojnë cenueshmërinë e tyre. Në Shqipëri, stigma shoqërore dhe diskriminimi sistemik rëndohen edhe më tepër nga mbrojtjet e pamjaftueshme ligjore dhe mungesa e shërbimeve mbështetëse të aksesueshme dhe të përshtatura për nevojat e tyre. Për rrjedhojë, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë më të rrezikuara nga dhuna, gjë që thekson nevojën urgjente për ndërhyrje të posaçme për to.

Për të luftuar me efektivitet dhunën ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, është shumë e rëndësishme të zbatohet dhe përmirësohet kuadri ligjor me dispozita që i kushtohen posaçërisht kësaj kategorie të popullsisë, si edhe të organizohen fushata ndërgjegjësimi në shkallë kombëtare, ku të përdoren materiale të aksesueshme, me qëllim zvogëlimin e stigmës. Shërbimet publike duhet të jenë plotësisht të aksesueshme, me fonde të posaçme të dedikuara për organizatat që ofrojnë shërbime për këto gra. Shërbimet e reagimit emergjent duhet të strukturohen në mënyrë të përpiktë për të adresuar kërkesat unike të grave me aftësi të kufizuara, duke garantuar kështu sigurinë e tyre në kohë krize dhe duke lehtësuar aksesin në ndihmën e shpejtë. Teknologjia duhet të përdoret për të rritur aksesin për gratë me aftësi të kufizuara, duke krijuar mekanizma të aksesueshëm raportimi për rastet e dhunës dhe duke zhvilluar mjete digjitale për edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit. Duhet të krijohet një sistem solid për mbledhjen e të dhënave, i cili të shërbejë si bazë për hartimin e politikave dhe përfshirja e grave me aftësi të kufizuara në proceset e vendimmarrjes, monitorimit dhe vlerësimit, është me rëndësi

¹ Dokumenti u hartua nga Grupi i Tematik dhe Rezultateve Gjinore të OKB-së (GTRG) me kontribute thelbësore nga Agustela Nini-Pavli, Konsulente gjinore dhe të Drejtave të Njeriut, UN Women Albania, dhe Monika Kocaqi, Konsulente e Lartë Kombëtare për Integrimin Gjinor dhe Dhunën ndaj Grave.

² Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) 2024. "The Disability and Development Report 2024, "Accelerating the realization of the Sustainable Development Goals by, for and with persons with disabilities" (Raporti mbi Aftësinë e Kufizuar dhe Zhvillimin 2024, "Përshejtimi i realizimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nga, për dhe me personat me aftësi të kufizuara"). <https://social.desa.un.org/publications/un-flagship-report-on-disability-and-development-2024>

thelbësore. Duhet të nxiten dhe përkrahen nismat për angazhimin e komunitetit dhe të krijohet një rrjet gjithëpërfshirës shërbimesh mbështetëse posaçërisht për problemet e dhunës, me personelin dhe fondet e duhura. Përveç kësaj, është e nevojshme të zhvillohen trajnime të specializuara për ofrueset/ofruesit e shërbimeve dhe punonjëset/punonjësit e organeve të ligjit dhe rendit, për ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe reagimin ndaj dhunës me bazë gjinore. Nismat e barazisë gjinore duhet të integrohen në të gjitha politikat përkatëse, si edhe duhet të krijohet një Fond Social i Punësimit për mbështetjen e integritit në tregun e punës të grave me aftësi të kufizuara që përballen me dhunë apo ngacmime. Programet e fuqizimit ekonomik të krijuara posaçërisht për gratë me aftësi të kufizuara, duke përfshirë iniciativat e trajnimit profesional dhe punësimit, duhet të kenë prioritet në mënyrë që të zvogëlohet varësia dhe të zbutet cenueshmëria ndaj dhunës ekonomike dhe abuzimit.

Sipas të dhënave të Censurit më të fundit, shkalla e përhapjes së aftësisë së kufizuar në Shqipëri ndër personat nga moshja 5 vjeç e lart është 6,5%. Në radhët e personave me të paktën një aftësi të kufizuar, shumica ishin gra (56%) krahasuar me burrat (44%), çka vë në pah nevojën për politika të posaçme që trajtojnë sfidat unike me të cilat përballen gratë me aftësi të kufizuara. Të dhënat nga Vrojtimi Kombëtar i vitit 2018 mbi Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri treguan se 52,9% e grave të moshës 18-74 vjeç kishin përjetuar të paktën një formë dhune – qoftë dhunë nga partneri intim, dhunë në lidhje dashurie, dhunë nga jo-partneri, ngacmim seksual ose përndjekje – gjatë jetës së tyre. Krahas kësaj, 36,6% e të anketuarave raportuan se kishin përjetuar një ose më shumë nga këto forma të dhunës në 12 muajt para studimit. Këto statistika vënë në pah natyrën e përhapur të dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri, por vënë në pah edhe një mangësi kritike, që përvojat e veçanta të grave me aftësi të kufizuara nuk janë përfshirë apo trajtuar siç duhet.

Dhuna ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në të gjithë botën përballen me të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, shpesh me tipare unike që lidhen me aftësitë e kufizuara të tyre. Organizata Botërore e Shëndetësisë raporton se ato kanë dy deri në katër herë më shumë gjasa që të përjetojnë dhunë nga partneri intim, krahasuar me gratë që nuk kanë aftësi të kufizuara.³ Një studim në Evropën Juglindore dhe Lindore tregon se gratë me aftësi të kufizuara raportojnë përhapje më të madhe të formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore – përfshirë dhunë fizike, seksuale dhe psikologjike – nga ushtrues të ndryshëm të kësaj dhune. Dhuna si nga partnerët intimë ashtu edhe nga jo-partnerët, si dhe ngacmimi seksual, janë shumë më të përhapura në këtë grup.⁴ Raporti i fundit i OKB-së mbi Aftësinë e Kufizuar dhe Zhvillimin tregon se gratë me aftësi të kufizuara janë veçanërisht të rrezikuara nga dhuna seksuale, ku 8 për qind e grave me aftësi të kufizuara, krahasuar me 5 për qind të grave që nuk kanë aftësi të kufizuara, kanë pësuar dhunë seksuale gjatë 12 muajve të fundit (para studimit). 13 për qind e grave me aftësi të kufizuara, krahasuar me 10 për qind të grave që nuk kanë aftësi të kufizuara, përjetojnë dhunë seksuale të paktën një herë gjatë jetës së tyre. Përveçse i nënshtrohen të njëjtës dhunë, shfrytëzim dhe/ose abuzim ndaj grave dhe praktikave të dëmshme të kryera ndaj grave në përgjithësi, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë gjithashtu subjekt i manifestimeve specifike të dhunës si mohimi i ushqimit ose ujit, ose kërcënimi me ndonjë nga këto akte; heqja e qenve ndihmës ose pajisjeve ndihmëse; kufizimi i aksesit për të tjerët; procedurat ose ndërhyrjet e detyruara mjekësore pa pëlqim të lirë dhe të informuar, duke përfshirë në kontekstin e shëndetit seksual dhe riprodhues si sterilizimi ose kontracepsioni i detyruar; shfrytëzimi ekonomik, neglizhimi, poshtërimi, fshehja, braktisja, abuzimi, përfshirë abuzimin seksual dhe shfrytëzimin seksual nga institucionet shtetërore dhe joshetërore, brenda familjes ose komunitetit; si dhe vrasja e foshnjave.⁵

³ Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). 2023. "Disabilities" (Aftësitë e Kufizuara). Shih: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/disability-and-health>.

⁴ UNFPA, 2020. "Violence against women living with disabilities in South-East and Eastern Europe - UNFPA Evidence Brief based on OSCE-led Survey on the Well-being and Safety of Women in South-East Europe and Eastern Europe" (Dhuna ndaj grave që kanë aftësi të kufizuara në Evropën Juglindore dhe Lindore – Dosje faktike e UNFPA-së bazuar në vrotimin e drejtuar nga OSBE-ja mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Evropën Juglindore dhe Lindore). Shih: <https://eeca.unfpa.org/en/publications/violence-against-women-living-disabilities-south-east-and-eastern-europe>

⁵ Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) 2024. "The Disability and Development Report 2024, "Accelerating the realization of the Sustainable Development Goals by, for and with persons with disabilities" (Raporti mbi Aftësinë e Kufizuar dhe Zhvillimin 2024, "Përsheptimi i realizimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nga, për dhe me personat me aftësi të kufizuara"). <https://social.desa.un.org/publications/un-flagship-report-on-disability-and-development-2024>

Ndër format kryesore të dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara janë⁶:

Dhuna fizike – shtyrja, goditja me shuplakë dhe forma të tjera të lëndimit fizik, që shpesh përkeqësohen nga fakti që viktimat është e varur nga abuzuesi për kujdes. Ndër abuzimet specifike që lidhen me aftësinë e kufizuar mund të jenë mosdhënia e kujdesit mjekësor, detyrimi për të përdorur substanca narkotike ose alkool, si dhe pengimi i aksesit në mjete ndihmëse të domosdoshme.

Dhuna seksuale – përfshirja në akte të llojit seksual me një person tjetër pa dhënie pëlqimi, përmes shtrëngimit, kërcënimeve ose shfrytëzimit të cenueshmërisë, pavarësisht nga marrëdhënia midis dhunuesit dhe viktimës, shpesh duke shfrytëzuar cenueshmërinë dhe varësinë e viktimës. Ajo përfshin përdhunimin dhe çfarëdo aktiviteti tjetër seksual pa pëlqim.

Ngacmimi seksual – kontakt fizik i padëshiruar, komente të palejueshme dhe forma të ndryshme të ngacmimit jofizik, ndër të cilat përndjekja dhe sjelljet sugjестive të nënkuptuara.

Dhuna psikologjike – ushtrimi i kontrollit dhe imponimi i vullnetit mbi një person/grua, përmes frikësimit dhe kërcënimeve, shpesh duke izoluar ato nga rrjetet mbështetëse dhe duke i bërë që të mos kenë besim tek të tjerët.

Dhuna emocionale – sulmimi i vetëvlerësimit përmes abuzimit me fjalë dhe neglizhimit emocional, sidomos ndaj personave që janë të varur nga kujdestaret/kujdestarët e tyre (nënloj i dhunës psikologjike).

Dhuna ekonomike – kontrollimi i aksesit në burimet financiare dhe mundësitë e punësimit, duke bërë që të vazhdojë gjendja e varësisë dhe duke penguar pavarësinë.

Shkelja e të drejtave seksuale ose riprodhuese – shtrëngimi për kryerjen e procedurave mjekësore dhe mohimi i shërbimeve të nevojshme të shëndetit seksual, që çojnë në sterilizime dhe aborte të detyruara, që bazohen në stereotipe të dëmshme.

Dhuna obstetrike – ndërhyrje mjekësore të panevojshme gjatë lindjes, nga të cilat preken shumë më tepër gratë me aftësi të kufizuara (që lidhet me kujdesin amësor).

Dhuna institucionale – neglizhimi, abuzimi dhe shkeljet sistematike të të drejtave të një personi/gruaje (në institucionet e përkujdesit), që shpesh përkeqësohen nga reagimet e pamjaftueshme të autoriteteve. Institucionalizimi i detyruar është gjithashtu shqetësim i konsiderueshëm, sidomos për gratë me aftësi të kufizuara intelektuale ose psikosociale.

Dhuna ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri

Stigma dhe stereotipet për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara⁷ kanë rrënjë të thella në normat kulturore dhe tradicionale shqiptare. Konceptet tradicionale dhe qëndrimet kulturore shpesh e shohin aftësinë e kufizuar si një tipar turpëruar ose negativ, gjë që çon në izolimin e grave me aftësi të kufizuara. Familjet mund të mendojnë se pasja e një anëtareje/anëtari me aftësi të kufizuara turpëron ose është fatkeqësi për familjen, duke ndikuar kështu në statusin social të tyre. Pritshmëritë e shoqërisë lidhur me rolet gjinore i kontribuojnë kësaj stigme. Gratë me aftësi të kufizuara mund të shihen se nuk janë të afta të përmbushin rolet e tyre tradicionale si kujdestare apo shtëpiake, që çon në marginalizimin e mëtejshëm të tyre. Mbizotëron besimi se gratë me aftësi të kufizuara janë më pak të preferuara si partnere për martesë, që mund të shtojë presionin ndaj familjeve që t'i fshehin dhe izolojnë këto gra. Kjo mund të çojë në kufizimin e mundësive të tyre për komunikim dhe mbështetje sociale. Stereotipet mund të ndikojnë në aksesueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve të disponueshme për gratë me aftësi të kufizuara. Ofrueset/ofruesit e shërbimeve shëndetësore dhe të shërbimeve sociale mund të kenë paragjykimë që ndikojnë në gatishmërinë e tyre për të ofruar kujdesin dhe ndihmën e duhur. Gratë me aftësi të kufizuara shpesh

⁶ OAS/CIM/MESECVI. 2022. *Gender-Based Violence against Girls and Women with Disabilities* (Dhuna me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara). <https://belemopara.org/wp-content/uploads/2023/05/Report-Violence-Disabilities.pdf>; Forumi Evropian i Aftësisë së Kufizuar. 2021.

Recommendations on EU policies to combat violence against women and girls with disabilities (Rekomandime mbi politikën e BE-së për luftimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara). <https://www.edf-feph.org/content/uploads/2021/05/final-EDF-position-paper-on-Violence-against-women-and-girls-with-disabilities-in-the-European-Union.pdf>; Këshilli i Evropës. 2011. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. <https://rm.coe.int/168046031c>

⁷ UNDP. 2015. *Profile of Social Exclusion of Persons with Disabilities* (Profili i përjashtimit social të personave me aftësi të kufizuara). <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Profili-PAK-shqip-web.pdf>; UNDP dhe FSHDPAK. 2015. *Dhunë e padukshme – një vështrim mbi fenomenin e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri*.

https://adrf.al/images/publications/Invisible_violence_adrf_report_eng.pdf; UN Women dhe FSHDPAK. 2018. "Raport vlerësimi: Dhuna ndaj grave dhe vajzave nga komunitete të pafavorizuara – një vështrim mbi fenomenin e dhunës ndaj grave dhe vajzave nga komuniteti rom, LGBT, dhe atyre me aftësi të kufizuara në bashkitë Elbasan, Vlorë, Tiranë dhe Shkodër". https://adrf.al/images/publications/Raporti-Dhuna_ndaj_Grave_Vajzave.pdf

përballen me barriera të konsiderueshme në arsimim dhe punësim për shkak të stereotipeve negative për aftësitë e tyre. Kjo mund të bëjë që ciklet e varfërisë dhe varësisë të vazhdojnë të përsëriten.

Format kryesore të dhunës. Studime nga organizata të shoqërisë civile të specializuara në këtë fushë⁸ në Shqipëri tregojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përballen me forma të ndryshme të dhunës. Ato që kanë aftësi të kufizuara intelektuale dhe probleme të shëndetit mendor janë veçanërisht të cenueshme për shkak të vështirësive për të njohur dhe denoncuar abuzimin. Gratë me aftësi të kufizuara fizike, pamore, ose të të folurit shpesh përjetojnë dhunë psikologjike dhe fizike që lidhet me varësinë e tyre nga kujdestarja/kujdestari, që rëndohet më shumë nga paragjykimet e shoqërisë të cilat çojnë në dhunë pasive që ndikon në shëndetin e tyre mendor. Ndër format më të përhapura të abuzimit përfshihen mosdhënia e barnave, izolimi në shtëpi për shkak të mjeteve ndihmëse të prishura ose jofunksionale, si dhe kufizimi fizik për shkak të shërbimeve mbështetëse të pamjaftueshme. Dhuna emocionale si për shembull kërcënimi nga anëtare/anëtarë të familjes se do t'i braktisin personat që përdorin karrige me rrota, ose për mundësinë e institucionalizimit të vajzave me aftësi të kufizuara, ilustron ndikimin e thellë të abuzimit emocional në këtë kontekst. Gratë me aftësi të kufizuara intelektuale dhe probleme të shëndetit mendor të nivelit mesatar janë veçanërisht të cenueshme nga dhuna seksuale, trafikimi i qenieve njerëzore, prostitucioni dhe lypja, sepse problemet e tyre mund të shtojnë rrezikun e shfrytëzimit. Dhuna psikologjike e ushqyer nga paragjykimet e shoqërisë, çon në shkelje të të drejtave të arsimimit, punësimit, jetës familjare dhe përfshirjes në komunitet. Presionet financiare janë të konsiderueshme, sepse shumë grave me aftësi të kufizuara u mohohet aksesin në pronat dhe asistencë sociale, që çon në institucionalizimin ose braktisjen e tyre.

Profili i abuzuesve. Abuzimi mund të ndodhë kudo, në mjedise private dhe publike, por më shpesh kur gruaja ose vajza ka akses të kufizuar në ndihmë ose kur nuk ka dëshmitare/dëshmitarë të abuzimit. Kjo mund të ndodhë në institucione dhe jashtë institucioneve (familje, punë, ose hapësira publike). Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara zakonisht pësojnë abuzim prej personave që janë, ose duhet të jenë, më të afërt me to: anëtare/anëtarë të familjes, përfshirë prindërit, vëllezërit e motrat dhe gjyshërit (që mund të shfrytëzojnë varësinë e grave me aftësi të kufizuara për kujdes dhe mbështetje); partneret/partnerët intimë ose bashkëshortet/bashkëshortët (për shkak të dinamikës së pushtetit, ku abuzuesja/abuzuesi mendon se ka të drejtën të ketë nën kontroll partneren); dhe kujdestaret/kujdestarët ligjorë (që mund të abuzojnë me pushtetin e tyre duke kufizuar pavarësinë, keqpërdorur burimet financiare dhe duke kontrolluar aksesin e tyre në shërbime të domosdoshme). Ndër abuzueset/abuzuesit e tjerë janë kujdestaret/kujdestarët dhe ofrueset/ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor (të cilat/cilët shfrytëzojnë pozitën që u është besuar). Varësia fizike, ekonomike dhe shoqërore përkeqëson më tej cenueshmërinë e grave me aftësi të kufizuara kur ato përpiqen të kërkojnë ndihmë ose shërbime, ose kur përpiqen të largohen nga situata abuzive.⁹

Marrëdhënia reciproke midis aftësisë së kufizuar dhe dhunës ndaj grave krijon rreth vicioz kompleks dhe të dëmshëm. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara shpesh perceptohen si më të cenueshme, duke i bërë ato të jenë në shënjestër të dhunës, sidomos kur janë të varura nga kujdestaret/kujdestarët, gjë që mund të shkaktojë pabarazi në pushtet dhe të shtojë rrezikun e abuzimit. Po kështu, aktet e dhunës mund të rezultojnë në lëndime të përhershme, që çojnë në aftësi të kufizuara afatgjata, ndërsa traumat mund të shkaktojnë probleme të shëndetit mendor që dëmtojnë funksionimin e përditshëm. Kjo dhunë keqëson izolimin social dhe ndërlikon përpjekjet për kërkimin e ndihmës. Gjithashtu, barriera si vështirësitë në komunikim dhe aksesin e kufizuar në burime pengojnë denoncimin e dhunës, ndërsa stigma që shoqëron aftësinë e kufizuar, ashtu edhe dhunën, i marginalizon më tej këta individë, duke bërë që cikli i dhunës të vazhdojë.

Shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës. Në Shqipëri, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përballen me pengesa të konsiderueshme në aksesimin e shërbimeve të përgjithshme dhe mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës. Ofrueset/ofruesit e shërbimeve shpesh nuk janë të ndërgjegjësuar për nevojat e veçanta të tyre dhe trajnimi i pamjaftueshëm pengon menaxhimin efektiv të rasteve. Kjo çon në reagime të mangëta dhe marginalizim të mëtejshëm. Shumë gra me aftësi të kufizuara nuk kanë dijeni për burimet në dispozicion, që shton

⁸ Po aty.

⁹ UN Women & FSHDPAK. 2018. "Raport vlerësimi: Dhuna ndaj grave dhe vajzave nga komunitete të pafavorizuara – një vështrim mbi fenomenin e dhunës ndaj grave dhe vajzave nga komuniteti rom, LGBT, dhe atyre me aftësi të kufizuara në bashkitë Elbasan, Vlorë, Tiranë dhe Shkodër". https://adrf.al/images/publications/Raporti-Dhuna_ndaj_Grave_Vajzave.pdf; INSTAT. 2019. "Vrojtim kombëtar me bazë populatën: Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri". <https://www.instat.gov.al/media/6121/publikimi-dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave.pdf>

cenueshmërinë dhe izolimin e tyre. Mbështetja sociale në nivelin vendor është e fragmentuar dhe anëtarëve/anëtarëve të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit u mungojnë aftësitë e nevojshme për t'i trajtuar këto raste. Raporti tematik i kohëve të fundit i Grupit të Ekspertëve/Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) raporton mungesën e shërbimeve të posaçme që t'u përgjigjen nevojave të këtyre grave, të cilat përballen me barriera në mbrojtje për shkak të shërbimeve të paaksesueshme dhe paragjykimëve të ofruesve/ofruesve të shërbimeve. Përfitimet nga punësimi janë të pamjaftueshme dhe gratë me probleme të shëndetit mendor shpesh çohen në institucione psikiatrike të përgjithshme ku nuk u ofrohet mbështetja e duhur. Përveç kësaj, nuk ka masa që sigurojnë aksesueshmërinë në gjykata apo stacione policie për viktimat me aftësi të kufizuara, apo shërbime përkthimi për personat me aftësi të kufizuara në dëgjim. GREVIO i nxit autoritetet që të shtojnë aksesin në shërbime të specializuara për gratë që diskriminohen për shkak të përkatësisë të shumëfishta, sidomos për ato me aftësi të kufizuara.¹⁰

Një numër **organizatash të shoqërisë civile** (OSHC) në Shqipëri punojnë për mbrojtjen e të drejtave të grave, fëmijëve dhe personave aftësi të kufizuara dhe promovojnë politika gjithëpërfshirëse. Ato ofrojnë mbështetje dhe mbrojtje ligjore, informacion të aksesueshëm për mbrojtjen dhe shërbimet kundër dhunës dhe abuzimit, theksojnë aksesin në drejtësi, kryejnë studime dhe hartojnë rekomandime konkrete, etj. Krahas kësaj, disa prej tyre janë përfshirë edhe në përgatitjen e raporteve alternative në lidhje me zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.¹¹ GREVIO ka vënë në dukje se pavarësisht mbështetjes më të madhe për organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në Shqipëri, procedurat e paqarta dhe pengesat burokratike i kanë penguar OJF-të që të sigurojnë fonde nga shteti. Si rezultat, organizatat që ofrojnë shërbime për gratë me aftësi të kufizuara viktimat të dhunës kanë pasur rënie të konsiderueshme në financim.

Mbledhja e të dhënave. Zbatimi i politikave efektive për luftimin e dhunës ndaj grave në Shqipëri varet nga mbledhja e të dhënave statistike solide të ndara sipas kategorive, dhe nga studimet mbi të gjitha format e dhunës, sikurse kërkohet nga Konventa e Stambollit.¹² Në Shqipëri, ka një mungesë të theksuar të mbledhjes dhe përpunimit sistematik të të dhënave mbi gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.¹³ Këtu përfshihen mungesa e informacionit të rëndësishëm për shërbimet e disponueshme, për reagimet institucionale, efektivitetin e masave mbrojtëse dhe ndjekjen e çështjeve në vijimësi, gjë që pengon zhvillimin e masave mbështetëse të synuara dhe çon në reagime me politika jo të efektshme. Krahas kësaj, këto mangësi pengojnë edhe punën për mbrojtjen e të drejtave, sepse kufizojnë aftësinë për të paraqitur argumente të bazuara në fakte. Në vërejtjet përmbyllëse për Shqipërinë të vitit 2019, Komiteti i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK)¹⁴ vuri në dukje shqetësimet për mungesën e të dhënave konkrete për zbatimin e ligjeve që trajtojnë dhunën në marrëdhëniet familjare. Këtu përfshihen statistikat e pamjaftueshme për personat me aftësi të kufizuara që përjetojnë dhunë, abuzim seksual dhe forma të shumëfishta diskriminimi. Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe ndarja e tyre sipas kategorive të ndryshme është me rëndësi kyçe për marrjen e vendimeve të bazuara në informacion dhe për krijimin e programeve mbështetëse efektive për gratë me aftësi të kufizuara.

¹⁰ Grupi e Ekspertëve/Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO). 2024. "First thematic evaluation report: Building trust by delivering support, protection and justice – ALBANIA" (Raporti i parë vlerësues tematik: ndërtimi i besimit përmes ofrimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë – Shqipëria). [1680b1a0ca \(coe.int\)](https://www.greivio.org/en/1680b1a0ca)

¹¹ Si p.sh.: Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD), Shoqata e Invalidëve të Punës e Shqipërisë (SHIPSH), Shoqata e Invalidëve Para- dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë (SHIPTSH), Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (MEDPAK), Shoqata "Ndihamoni jetën" (SHNJ), Down Syndrome Albania, Fondacioni "Së bashku", Shoqata "Vepro tani" (2019); Caritas Albania (2019); Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë (2019); Fondacioni "Së bashku" në bashkëpunim me DSA, ANAD, MEDPAK, HLA dhe Caritas Albania (2024).

https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/TBSearch.aspx?Lang=en&TreatyID=4. Një listë e zgjeruar e OSHC-ve përfshirë ato puna e të cilave përqendrohet tek gratë me aftësi të kufizuara gjendet në Qendrën Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri.

<https://resourcecentre.al/csos-directory/>

¹² Këshilli i Evropës. 2011. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

<https://rm.coe.int/168008482e>

¹³ Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK). 2022. "Dokument orientues: gratë me aftësi të kufizuara në statistikat për gratë viktimat të dhunës".

https://adrf.al/images/publications/Dokument_Orientues_Grate_me_Aftesi_te_Kufizuara_ne_Statistikat_per_Grate_Viktima_te_Dhunes.pdf

¹⁴ <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/g19/304/81/pdf/g1930481.pdf>

Kuadri ligjor ndërkombëtar, kuadri ligjor dhe i politikave kombëtare dhe mangësitë

Kuadri ligjor ndërkombëtar lidhur me dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuara

Një numër traktatesh ndërkombëtare trajtojnë dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuara dhe që theksojnë ndërthurjen e barazisë gjinore dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Të gjithë këto traktate kërkojnë njohjen, parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara në shkallë globale. Shqipëria është palë në to dhe, pas ratifikimit nga Kuvendi, janë bërë pjesë e legjislacionit kombëtar dhe duhet të udhëzojnë përpjekjet e qeverisë për përmirësimin e legjislacionit mbi dhunën ndaj grave, përfshirë ndaj grave me aftësi të kufizuara.

Mekanizmat e traktateve të të drejtave të njeriut kanë hartuar edhe udhëzues dhe rekomandime të detajuara që u drejtohen shteteve, përfshirë Shqipërinë, në lidhje me zbatimin e dispozitave përkatëse. Krahas kësaj, jurisprudenca e organizmave në kuadër të traktateve të të drejtave të njeriut dhe e organeve gjyqësore përfshin raste që kanë të bëjnë me shkeljet nga ana e shteteve të të drejtave të grave me aftësi të kufizuara viktime të dhunës me bazë gjinore, të kryera nga organe publike ose individë. Ky kuadër duhet të shërbejë si udhëzues për çdo proces për rishikimin dhe përmirësimin e legjislacionit shqiptar që trajton dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuara.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) (2006), në nenet 6 dhe 16 njeherisht vështirësitë unike me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara dhe bën thirrje për garantimin e mbrojtjes së tyre nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi. Komiteti i KDKPAK-ut, në kontekstin e tre funksioneve kryesore të tij¹⁵ ka miratuar [Komentin e përgjithshëm nr. 3](#) për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, me udhëzime konkrete për masat përkatëse. Së fundi, Komitetit mund t'i paraqiten edhe ankesa kundër shteteve nga individët, për shkelje të dispozitave të Konventës, ndër të tjera edhe për rastet kur shtetet nuk sigurojnë mbrojtje të duhur ose shërbime të aksesueshme për gratë me aftësi të kufizuara viktime të dhunës, veçanërisht gjatë proceseve gjyqësore.¹⁶ Shqipëria ende nuk është palë në Protokollin Shtesë të KDKPAK-ut të Kombeve të Bashkuara, që do t'u mundësonte individëve ose organizatave të personave me aftësi të kufizuara që të paraqesin ankesa kundër qeverisë. Mekanizmat e të drejtave të njeriut si Komiteti i KDKPAK-ut dhe Komiteti i CEDAW, si dhe UPR (Rishikimi Periodik Universal)¹⁷ kanë rekomanduar vazhdimisht që Shqipëria të ratifikojë Protokollin Shtesë¹⁸ të KDKPAK-ut.

Në mënyrë të ngjashme, Komiteti i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), ka miratuar [Komentin e përgjithshëm nr. 18](#) për gratë me aftësi të kufizuara dhe [Komentin e përgjithshëm nr. 35](#) që trajton dhunën ndaj grave, përfshirë ndaj grave me aftësi të kufizuara. Në tetor 2023, Komiteti CEDAW miratori i Vërejtjet Përmbyllëse më të fundit drejtuar Shqipërisë, ku ndër të tjera shprehu shqetësimin se gratë me aftësi të kufizuara shpesh përballen me forma të ndërthurura të diskriminimit për shkak të përkatësisë së shumëfishë, sidomos për sa i përket aksesit në drejtësi, arsimim, punësim dhe shërbim shëndetësor. Komiteti gjithashtu ka shqyrtuar raste që lidhen me dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuara.¹⁹

¹⁵ Një organ i përbërë nga eksperte/ekspertë të pavarur, i ngarkuar me: a) interpretimin e dispozitave të traktatit përmes komenteve të përgjithshme për tema specifike; b) rishikimin periodik të përparimit të shteteve në zbatimin e Konventës dhe nxjerrjen e rekomandimeve specifike përmes Vërejtjeve Përmbyllëse; dhe c) marrjen e ankesave të paraqitura nga individë kundër shteteve për shkelje të dispozitave të traktatit dhe kërkimin nga shtetet që të marrin masa ligjore në rast të një vendimi për shkelje. Sipas procedurës së tretë, Komiteti mund të marrë vetëm ankesa nga individët kundër shteteve që kanë njohur kompetencën e Komitetit për marrjen e këtyre ankesave, përmes ratifikimit të Protokollit Opsional të KDKPAK-ut, si dhe pasi të jenë shtetuar të gjitha mjetet ligjore vendase.

¹⁶ Shih për shembull, Komiteti i KDKPAK-ut (2019), Çështja Z. Kundër Tanzanisë.

https://www.google.com/url?sa=t&source=web&rct=j&opi=89978449&url=https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx%3Fsy_mbolno%3DCRPD%252FC%252F22%252FD%252F24%252F2014%26Lang%3Den&ved=2ahUKewjVkfbo-vNaIAxW5bKQEhU7ULRgQFnoECBgQAQ&usq=AOvVaw0kCUo0rhKaNKFAKH5sliJS0

¹⁷ [Rishikimi Periodik Universal](#) (UPR) është një mekanizëm unik i Këshillit për të Drejtat e Njeriut, që kërkon nga çdo shtet anëtar i OKB-së t'i nënshtrohet një rishikimi të të dhënave të tij për të drejtat e njeriut çdo 4.5 vjet.

¹⁸ Protokollin Opsional krijon një mekanizëm individual të ankesave për KDKPAK-un. Shtetet palë që ratifikojnë Protokollin Opsional bien dakord të njohin kompetencën e Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për të shqyrtuar ankesat nga individë ose grupe që pretendojnë se të drejtat e tyre sipas Konventës janë shkelur. Komiteti mund të kërkojë informacion nga një palë dhe t'i bëjë rekomandime. Përveç kësaj, shtetet palë mund ta lejojnë Komitetin të hetojë, raportojë dhe të bëjë rekomandime për "shkeljet e rënda ose sistematike" të Konventës. Shtetet palë mund të heqin dorë nga ky detyrim i fundit me nënshkrim ose ratifikim.

¹⁹ Shih për shembull Komiteti i KEGJFDG-së (2020), Çështja e V.C. kundër Moldavisë, <https://juris.ohchr.org/casedetails/3041/en-US>

Rasti i R.P.B. kundër Filipineve: Komiteti i KEGJFDG-së²⁰

Kjo çështje kishte të bënte me përdhunimin e një vajze shtatëmbëdhjetëvjeçare, që nuk flet dhe dëgjon, nga fqinji i saj nëntëmbëdhjetëvjeçar në vitin 2006. Gjykimi i çështjes vazhdoi për pesë vjet dhe në fund i pandehuri u shpall i pafajshëm në vitin 2011. Gjykata e Filipineve u mbështet në mite dhe stereotipe gjinore për përdhunimin dhe viktimat e përdhunimit dhe arriti në përfundimin se viktimat duhet të kishin shfrytëzuar çdo mundësi për t'i shpëtuar ose rezistuar personit që e sulmoi. Përveç kësaj, autoritetet shtetërore nuk i ofruan R.P.B.-së përkthim në gjuhën e shenjave. Komiteti konkludoi se ofrimi i përkthimit në gjuhën e shenjave ishte i domosdoshëm për të siguruar pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të R.P.B.-së në proces. Gjithashtu, Komiteti konkludoi se pala shtetërore gaboi që u mbështet në stereotipe gjinore, që çoi në diskriminim me bazë seksin dhe gjininë, dhe që nuk i mori parasysh rrethanat individuale të çështjes, siç ishin aftësia e kufizuar dhe moshja e R.P.B.-së. Komiteti rekomandoi që shteti t'i jepte R.P.B.-së kompensimin e duhur dhe këshillim psikologjik pa pagesë, të rishikonte legjislacionin ekzistues dhe të hiqte dispozitën sipas së cilës sulmi seksual duhet të kryhet me ushtrim të forcës ose dhunës, të garantojë ndihmën e përshtatshme dhe pa pagesë nga përkthyeset/përkthyesit, të sigurojë që të gjitha procedurat penale që kanë të bëjnë me përdhunimin ose vepra të tjera penale seksuale të kryhen me paanshmëri dhe drejtësi, pa paragjykim dhe koncepte stereotipike në lidhje me gjininë, moshën dhe aftësinë e kufizuar të viktimës, dhe të ofrojë trajnime të përshtatshme dhe të rregullta për autoritetet gjyqësore dhe të rendit në lidhje me Konventën dhe Protokollin Shtesë.

Vendime të Komitetit, si ky i cituar më lart, trajtojnë detyrime të rëndësishme për shumë shtete, përfshirë Shqipërinë, që kanë mangësi të ngjashme, si për shembull mungesa e përkthimit për gratë me probleme dëgjimi, ose përkufizimi i dhunës seksuale në legjislacionin penal bazuar në përdorimin e forcës, që shpesh ndikon tek gratë me aftësi të kufizuara që janë viktimat të përdhunimit. Gjithashtu, shumica e këtyre rasteve paraqiten nga OSHC-të që punojnë në atë fushë dhe janë pjesë e punës së tyre për mbrojtjen e të drejtave dhe e planeve për ngritjen e padive strategjike. Megjithatë asnjë rast kundër Shqipërisë nuk është paraqitur ndonjëherë në Komitetin CEDAW deri më sot.

Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (1995), ndonëse nuk është traktat, por një komizë gjithëpërfshirëse mbi barazinë gjinore (që ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe në influencimin e lëvizjeve të grave me aftësi të kufizuara në të gjithë botën²¹) thekson eliminimin e dhunës ndaj grave, përfshirë ndaj atyre me aftësi të kufizuara, dhe bën thirrje për politika që garantojnë sigurinë e tyre.

Konventa e Stambollit (Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje) kërkon nga shtetet të sigurojnë që të gjitha masat për parandalimin, mbrojtjen dhe shërbimet për viktimat e dhunës të trajtojnë edhe prioritetet e grave me aftësi të kufizuara, të cilat, së bashku me grupe të tjera specifike, mund të jenë më të cenueshme nga rrethanat të caktuara.²² Në shtator 2024, GREVIO – organi i përbërë nga eksperte/ekspertë të pavarur, i ngarkuar me monitorimin e zbatimit të Konventës – nxori [raportin vlerësues tematik për Shqipërinë](#), ku ndër të tjera, evidentoi disa mangësi për sa i përket ofrimit të mbrojtjes dhe të shërbimeve për gratë me aftësi të kufizuara viktimat të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Mbrojtja e grave me aftësi të kufizuara viktimat të dhunës parashikohet edhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) e cila ka shqyrtuar një numër çështjesh gjyqësore në lidhje me këto aspekte në bazë të nenit 2 – e drejta për jetë; nenit 3 – ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues; ose nenit 8 – e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare. Standardet e krijuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së në përgjithësi janë detyruese për të gjitha shtetet anëtare dhe vendimet në vijim dhe të tjera të ngjashme duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për autoritetet dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara. Në GJEDNJ nuk janë bërë ankesa kundër Shqipërisë për raste që lidhen me dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuara. Që kur Shqipëria u bë anëtare e Këshillit të Evropës në vitin 1995, ka pasur vetëm një rast padie kundër Shqipërisë që kishte lidhje me dhunën

²⁰ CEDAW/C/57/D/34/2011, R.P.B. kundër Filipineve <https://juris.ohchr.org/casedetails/1875/en-US>

²¹ International Disability Alliance (IDA). 2023. *From Beijing to the CRPD: the missing keystone* (Nga Pekini në KDPK: themeli i munguar). https://www.internationaldisabilityalliance.org/sites/default/files/documents/ida_beijing_reportfinal_16-03-2023.pdf

²² Këshilli i Evropës. 2011. *Explanatory Report to the Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence* (Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje). <https://rm.coe.int/1680a48903>

ndaj grave (në përgjithësi).²³ Kjo pavarësisht nga praktika gjyqësore shumë e pasur në këtë fushë, e zhvilluar me kontributin e konsiderueshëm të organizatave për të drejtat e grave dhe avokateve/avokatëve në Evropë, që përfaqësojnë gratë viktime të dhunës.²⁴

G.M. dhe të tjerët kundër Republikës së Moldavisë, GJEDNJ (nr. 44394/2015)²⁵

Kjo çështje kishte të bënte me detyrimin për kryerjen e abortit dhe masat për kontrollimin e lindjeve të marra ndaj tri grave me aftësi të kufizuara intelektuale në një institucion neuropsikiatrik, pasi ishin përdhunuar në mënyrë të përsëritur nga një prej mjekëve kryesorë atje, si dhe me hetimin e kryer në lidhje me ankesat e tyre. Gjykata vendosi se ishte shkelur neni 3 (ndalim i trajtimit çnjerëzor dhe degradues) i Konventës, si në aspektin material ashtu edhe në atë procedural. Gjykata vuri në dukje në veçanti se autoritetet vendase nuk i kishin hetuar në mënyrë të efektshme pretendimet e ankueseve për keqtrajtim, megjithëse çështja ishte rihapur katër herë pas ankimit të tyre. Për më tepër, gjatë hetimeve nuk ishte marrë parasysh cenueshmëria e tyre si gra me aftësi të kufizuara intelektuale që ishin abuzuar seksualisht në një kontekst institucional. Gjykata konstatoi gjithashtu se e drejta penale e vendit nuk kishte ofruar mbrojtje efektive ndaj këtyre ndërhyrjeve mjekësore invazive, të kryera pa dhënien e pëlqimit të vlefshëm prej pacienteve.

Më 25 prill 2024, Parlamenti Evropian miratoi Direktivën e BE-së për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, që është ligji i parë me fuqi detyruese në BE në këtë fushë dhe një arritje e madhe për përparimin e barazisë gjinore në BE dhe më gjerë. Ligji i ri përmban masa për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe vendos standarde për mbrojtjen e viktimave të këtyre veprave penale. Gjithashtu, ai kërkon nga të gjitha vendet e BE-së që të penalizojnë me ligj gjymtimin gjenital femëror, martesat e detyruara dhe dhunën kibernetike, si për shembull shpërndarjen e pamjeve intime pa pëlqimin e personit. Direktiva njeh faktin që gratë me aftësi të kufizuara përjetojnë shumë më tepër dhunë dhe shpesh hasin vështirësi në aksesimin e mbrojtjes dhe të masave mbështetëse dhe, rrjedhimisht, u kërkon shteteve anëtare të BE-së të sigurojnë që ato të përfitojnë plotësisht nga të drejtat e përcaktuara në këtë Direktivë, njësoj si personat e tjerë, duke i kushtuar njëkohësisht vëmendjen e duhur cenueshmërisë së veçantë të këtyre viktimave dhe vështirësive që mund të kenë ato në kërkimin e ndihmës. Në të gjithë tekstin, Direktiva jep udhëzime të veçanta se si të zbatohen dispozita specifike për sa i përket grave me aftësi të kufizuara.²⁶

Legjislacioni dhe politikat kombëtare

Në Shqipëri ekziston një kuadër ligjor dhe i politikave në lidhje me dhunën ndaj personave me aftësi të kufizuara, ku përfshihet edhe ajo ndaj grave me aftësi të kufizuara. Mbrojtje specifike janë përfshirë në legjislacionin dhe politikat e përgjithshme që fokusohen në dhunën me bazë gjinore dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Me gjithë përmirësimet e bëra vitet e fundit, disa nga dispozitat ligjore kanë mangësi dhe nuk garantojnë mbrojtje efektive dhe shërbime të aksesueshme. Në të njëjtën kohë, ka mungesë harmonizimi ndërmjet dy fushave të legjislacionit dhe politikave. Në vijim paraqiten disa nga ligjet dhe politikat, si edhe mangësitë dhe vështirësitë kryesore që lidhen me zbatimin e tyre.²⁷

Legjislacioni kundër diskriminimit:

Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi (2010, i ndryshuar) ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë dhe aftësisë së kufizuar dhe ofron mbrojtje për gratë me aftësi të kufizuara, që duhet të shtrihet edhe tek gratë viktime të dhunës, bazuar në pranimin e faktit se dhuna ndaj grave është një prej manifestimeve më brutale të diskriminimit gjinor. Disa nga format relevante të diskriminimit të njohura në ligj përfshijnë diskriminimin për shkak të përkatësisë së shumfishtë, diskriminimin e tërthortë, gjuhën e urrejtjes, mohimin e akomodimit të arsyeshëm, ngacmimin,

²³ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. 2020. [Tërshana v. Albania \(Application No 48756/14\)](#)

²⁴ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. 2024. *Fact Sheet, Violence against Women* (Fletë informacion – Dhuna ndaj grave) https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/FS_Violence_Woman_ENG dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. 2023. *Fact Sheet on Domestic Violence* (Fletë informacion – Dhuna në familje). https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/FS_Domestic_violence_ENG

²⁵ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. 2024. *Factsheet – Persons with disabilities and the ECHR* (Fletë informacion – Personat me aftësi të kufizuara dhe KEDNJ-ja). https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/FS_Disabled_ENG

²⁶ Bashkimi Evropian. 2024. *Directive of the European Parliament and of the Council on combating violence against women and domestic violence* (Direktivën e BE-së për luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje). <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/PE-33-2024-INIT/en/pdf>

²⁷ Kjo analizë nuk synon të jetë shteruese dhe të trajtojë të gjitha aspektet e kuadrit legjislativ për dhunën me bazë gjinore dhe për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Ajo thjesht synon të sjellë në vëmendje nevojën për të filluar një analizë më të thelluar të legjislacionit dhe politikave, si në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara ashtu edhe në atë të dhunës me bazë gjinore, për të siguruar harmonizimin dhe zbatimin efektiv të tyre.

ngacimin seksual, segregimin dhe viktimizimin. Viktimat e këtyre formave dhe të formave të tjera të diskriminimit kanë të drejtë të paraqesin ankesa pranë Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe/ose në gjykata. Megjithatë, në përgjithësi nuk ka një praktikë të konsoliduar në jurisprudencën gjyqësore kundër diskriminimit dhe ka mungesë interpretimi të mbrojtjes nga diskriminimi në rastet e grave me aftësi të kufizuara viktimat të dhunës (për shembull, një grua që nuk ka mundësi të ketë akses në shërbime të specializuara për shkak të aftësisë së kufizuar). Kjo vjen pjesërisht nga mungesa e ndërgjegjësimit dhe e njohurive mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe diskriminimin gjinor nga organet kundër diskriminimit, organet e tjera publike, shoqëria civile dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara.

Legjislacioni dhe politikat lidhur me dhunën me bazë gjinore

Ligji për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare (2006, i ndryshuar), ofron mbrojtje specifike për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me parimin e akomodimit të arsyeshëm (neni 1/2 dhe neni 6/c). Aktet nënligjore, të miratuara në mbështetje të zbatimit të ligjit (si për shembull për menaxhimin e rasteve, ofrimin e shërbimeve²⁸), përmbajnë disa kërkesa të përgjithshme për shërbime të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara që janë viktimat të dhunës në familje. Por, mungojnë rregulloret dhe protokollet specifike që trajtojnë aspekte të shumëfishta të aksesueshmërisë për gratë me aftësi të kufizuara të ndryshme. Për shembull, në raportin e tij të fundit, GREVIO vuri në dukje se nuk ka protokolle ose procedura standarde të veprimit për trajtimin e grave viktimat të dhunës me aftësi të kufizuara mendore.²⁹ Kjo është e vërtetë edhe për gratë me aftësi të kufizuara të llojeve të tjera, si fizike, shqisore, ose intelektuale.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ 2021-2030) siguron që masat për zvogëlimin e të gjitha formave të praktikave të dëmshme të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje (Qëllimi strategjik III) të kenë në fokus gratë, përfshirë gratë me aftësi të kufizuara, në të gjithë diversitetin e tyre. Strategjia përfshin gjithashtu masa për shërbime të aksesueshme për viktimat e dhunës me bazë gjinore që kanë ndonjë aftësi të kufizuar. Por, ashtu siç përmendet edhe në raportin e GREVIO-s, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të marrë parasysh sa duhet nevojat specifike të grave viktimat të dhunës, që janë objekt i diskriminimit për shkak të përkatësisë së shumëfishtë, si gratë me aftësi të kufizuara, përfshirë ato me probleme të shëndetit mendor. Këto zotime duhet të ndiqen nga hapa, veprime dhe financime të prekshme.³⁰

Legjislacioni penal dhe aksesin në drejtësi

Kodi Penal i Shqipërisë kriminalizon dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, ku përfshihen edhe veprat penale të kryera kundër grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, Kodi e konsideron si rrethanë rënduese kryerjen e disa veprave penale kundër personave me aftësi të kufizuara (si në rastin e vrasjes dhe trafikimit të qenieve njerëzore), për të cilat jepen ndëshkime më të rënda për autorët. Krahas kësaj, një dispozitë e veçantë parashikon si vepër penale edhe marrëdhëniet seksuale me persona me aftësi të kufizuara duke shfrytëzuar aftësinë e kufizuar mendore ose fizike të viktimave. Megjithatë, forma të tjera të dhunës me bazë gjinore ndaj grave me aftësi të kufizuara nuk përbëjnë vepra penale specifike dhe nuk klasifikohen si krime të kryera në rrethana rënduese. Përveç kësaj, sterilizimi i detyruar, nga i cili mund të preken veçanërisht gratë me aftësi të kufizuara, që është edhe është një nga format e dhunës ndaj grave sipas Konventës së Stambollit, nuk përkufizohet si vepër penale në legjislacionin shqiptar. Kodi i ri Penal, që është në proces hartimi, është një mundësi për t'i zgjidhur këto mangësi, si edhe mangësi të tjera në legjislacionin shqiptar.

Legjislacioni procedural penal dhe civil në Shqipëri (Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Procedurës Civile) ka disa mangësi për sa i përket kërkesave që burojnë nga traktatet ndërkombëtare (sidomos nga neni 13 i KDPAK-ut) për akomodimin procedural dhe shërbime ligjore të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara, që prekin drejtpërdrejt gratë viktimat të dhunës. Në përgjithësi, sikurse vihet në dukje edhe nga Komiteti i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Shqipëri ka mungesë masash dhe protokolleve specifike

²⁸ VKM nr. 327, datë 2/06/2021 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare" dhe Urdhri Nr. 744 i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, datë 15.11.2019, "Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat/të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtra) publike dhe jopublike (strehëzat emergjente)".

²⁹ Grupi i Eksperteve/Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO). 2024. "First thematic evaluation report: Building trust by delivering support, protection and justice – ALBANIA" (Raporti i parë vlerësues tematik: ndërtimi i besimit përmes ofrimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë – Shqipëria). [1680b1a0ca \(coe.int\)](https://www.coe.int)

³⁰ Po aty.

për heqjen e barrierave ndaj aksesit në drejtësi dhe për t'u ofruar personave me aftësi të kufizuara akomodime të përshtatshme procedurale në përputhje me gjininë dhe moshën në procedurat gjyqësore, përfshirë sa i takon informacioneve me shkrim dhe komunikimeve në lidhje me shërbimet e notereve/noterëve.³¹

Miratimi i Ligjit për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti (2017) ishte një zhvillim i rëndësishëm që u ofroi grave me aftësi të kufizuara mundësi të përfitojnë ndihmë juridike falas për arsye të ndryshme, përfshirë për shkak të statusit të personit me aftësi të kufizuara, si viktimë e dhunës në familje ose e dhunës seksuale, dhe për shkak të përballjes me diskriminim. Numri i përfitueseve/përfituesve të ndihmës juridike parësore po rritet në sajë të disa qendrave të ndihmës juridike falas (QNJF) në të gjithë vendin.³² Janë vënë re disa përmirësime në ofrimin e ndihmës juridike dytësore falas (përfaqësim në gjykatë dhe/ose përjashtim nga shpenzimet gjyqësore dhe për ekspertet/ekspertët).³³ Megjithatë, nuk është e qartë nëse janë plotësuar kërkesat specifike të kategorive të veçanta, sidomos të grave me cenusshmëri të shumëfishta, si gratë me aftësi të kufizuara viktimë të dhunës, për shkak të mungesës së të dhënave të ndara sipas seksit dhe faktorëve të tjerë.

Legjislacioni për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Që nga ratifikimi i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara nga Shqipëria në vitin 2013, janë miratuar ligje dhe politika mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për të siguruar zbatimin e kësaj Konvente. Megjithatë, në këtë kuadër, ka një mungesë vëmendjeje ndaj gjendjes së grave me aftësi të kufizuara të cilat shpesh përballen me diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjinisë së tyre. Po kështu, mungojnë lidhjet dhe referencat me legjislacionin dhe politikën mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore. Për shembull, ndonëse Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara (2014) përmban garanci të përgjithshme për sigurimin e aksesueshmërisë në të gjitha fushat kryesore të jetës, ndër të cilat edhe në shërbimet e përkujdesit shoqëror, ai nuk përmend në mënyrë specifike legjislacionin për dhunën me bazë gjinore ose shërbimet e specializuara për gratë me aftësi të kufizuara viktimë të dhunës. Në mënyrë të ngjashme, Ligji për Shëndetin Mendor (2012, i ndryshuar), ndonëse garanton mbrojtjen e personave me probleme të shëndetit mendor nga diskriminimi, tortura, trajtimi çnjerëzor dhe degradues prej nëpunësve/nëpunësve/autoriteteve publike,³⁴ nuk përmban dispozita për garantimin e mbrojtjes nga dhuna, përfshirë nga dhuna me bazë gjinore, prej individëve (kujdestare/kujdestarë, anëtare/anëtarë të familjes, ofrueset/ofruesit privatë të shërbimeve, etj.).

Mungesa e fokusit dhe e të dhënave mbi gjendjen e grave me aftësi të kufizuara në Shqipëri u vu në dukje edhe nga Komiteti i KDPAK-ut, i cili në vitin 2019 theksoi mungesën e informacionit të besueshëm mbi nivelin e zbatimit dhe rezultateve të arritura nga Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020, për sa u përket grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.³⁵ Por, me gjithë rekomandimin konkret të Komitetit për trajtimin e këtij problemi, edhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2021-2025), që u hartua më pas, nuk i trajtoi mjaftueshëm çështjet që lidhen me format e ndërthurura të diskriminimit dhe dhunën me bazë gjinore me të cilën përballen gratë me aftësi të kufizuara.

Rekomandime

Duke pasur parasysh sfidat me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në Shqipëri, është e domosdoshme që organet legjislative, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, gjyqësori, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, ofruesit publikë dhe privatë të shërbimeve, organizatat e specializuara të shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare dhe komuniteti donator të bashkëpunojnë urgjentisht për të trajtuar format e ndërthurura të diskriminimit dhe dhunën me të cilën përballen ato. Ndër ndërhyrjet specifike mund të përfshihen:

³¹ Komiteti i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK). 2019. *Concluding Observations on Albania* (Vërejtje përmbyllëse për Shqipërinë). <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/g19/304/81/pdf/g1930481.pdf>

³² Që nga dhjetori 2023, ka 20 qendra të ndihmës juridike falas të menaxhuara nga Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas, 12 nga të cilat mbështeten nga buxheti i shtetit dhe 8 nga PNUD-i dhe Agjencia Austriake për Zhvillim. <https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/12.-Analiza-Statistikore-Dhjetor-2023.pdf>

³³ Në vitin 2022, nga ndihma juridike dytësore falas përfituan 982 persona, nga 1030 kërkesa gjithsej, 65% e kërkesave ishin nga gra. (Në vitin 2021, nga ndihma juridike dytësore falas përfituan 671 persona nga 849 kërkesa, nga të cilat 65% ishin nga gra); Në vitin 2023 u dhanë 773 vendime nga gjykatat në lidhje me kërkesat për ndihmë juridike dytësore falas. Të dhëna nga Raportet Vjetore të Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas, Shqipëri.

³⁴ Sipas Kodit Penal të Shqipërisë, tortura, trajnimi çnjerëzor dhe degradues janë vepra penale të kryera ose nxitura nga dikush që ushtron funksione publike.

³⁵ Komiteti i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK). 2019. *Concluding Observations on Albania* (Vërejtje përmbyllëse për Shqipërinë). <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/g19/304/81/pdf/g1930481.pdf>

Përmirësime dhe zbatim efektiv i kuadrit ligjor dhe të politikave: Të forcohen ligjet dhe politikat që trajtojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe dhunën ndaj grave, përmes përfshirjes së dispozitave që trajtojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi sfidat me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Të sigurohet harmonizimi ndërmjet ligjeve, politikave dhe mekanizmave zbatues të tyre. Të zbatohen mekanizmat e monitorimit të politikave dhe ligjeve përkatëse dhe të forcohet llogaridhënia e nëpunëseve/nëpunësve të administratës publike në rastet e mospërbushjes së detyrimeve të tyre. Ndërturja e gjinisë dhe aftësisë së kufizuar kërkon qasje të përshtatura në politikat që luftojnë dhunën, duke siguruar që strategjitë të adresojnë njëkohësisht barrierat e lidhura me gjininë dhe ato të lidhura me aftësinë e kufizuar. Krahas këtyre, duhet të integrohen edhe rekomandimet nga GREVIO, KDPK, KEGJFDG, dhe organe të tjera të traktateve ndërkombëtare për të siguruar që kuadri legjislativ dhe i politikave në Shqipëri të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Trajnimi i profesionisteve/profesionistëve: Të zhvillohet trajnim i specializuar për ofrueset/ofruesit e shërbimeve dhe punonjëset/punonjësit e rendit për ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e tyre mbi aftësitë e kufizuara, ndër të tjera edhe për kujdesin e informuar në raste të traumave dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si edhe reagimet efektive ndaj dhunës me bazë gjinore. Këto trajnime duhet të sigurojnë që shërbimet të jenë përfshirëse dhe respektuese. Krahas kësaj, të ofrohen trajnime të posaçme për OJF-të vendore që punojnë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, për forcimin e aftësive të tyre për të mbrojtur të drejtat e të mbijetuarave të dhunës dhe për të ofruar shërbime të domosdoshme për to.

Rritja e ndërgjegjësimin: Të zhvillohen fushata në shkallë kombëtare të organizuara nga qeveria dhe OSHC-të, për të promovuar ndërgjegjësimin për të drejtat dhe nevojat e grave me aftësi të kufizuara, duke theksuar ndërthurjen e aftësisë së kufizuar dhe dhunës me bazë gjinore. Është thelbësore që të përdoren materiale të aksesueshme dhe me gjuhë përfshirëse e të përshtatshme për të siguruar pjesëmarrje efektive të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në këto nisma.

Financimi: Të caktohen fonde të posaçme për organizatat që ofrojnë shërbime për gratë me aftësi të kufizuara, duke siguruar mbështetje të qëndrueshme për përpjekjet e tyre avokuese dhe ndërhyrjet e realizuara. Të trajtohen me prioritet në financim organizatat e drejtuara nga gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, për të forcuar zërin dhe për t'u kushtuar më shumë vëmendje nevojave të tyre.

OSHC-të për të drejtat e grave dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara: Të shtohet fokusi mbi çështjet që lidhen me të drejtat e grave me aftësi të kufizuara dhe dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuara, përfshirë në lidhje me ofrimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara të përshtatshme, organizimin e aktiviteteve të fokusuara te avokimi dhe monitorimi, si dhe këshillimin ligjor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për gratë me aftësi të kufizuara.

Mbledhja e të dhënave: Të krijohet një sistem gjithëpërfshirës për mbledhje sistematike të të dhënave të ndara sipas llojit të aftësisë së kufizuar për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të cilat përjetojnë dhunë, që ndihmon në hartimin e politikave dhe ndarjen e burimeve bazuar në informacion. Të mblidhen të dhëna për shkaqet, faktorët e riskut, aksesin në shërbime, tipologjinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse të specializuara, numrin dhe llojet e urdhrave të mbrojtjes që janë lëshuar, që janë zbatuar ose nuk janë zbatuar, ndihmën juridike falas, dhe efektivitetin e masave. T'i jepet prioritet një sistemi të thjeshtuar që shmang duplikimin e sistemeve ekzistuese, si sistemit të informimit në nivel vendor për regjistrimin e rasteve të dhunës në familje ("REVALB") dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke siguruar që ai të jetë i lehtë për t'u përdorur dhe të përditësohet vazhdimisht. Të bashkëpunohet me institucionet akademike ose OJF-të për të siguruar saktësi më të madhe të të dhënave. Të kryhen rregullisht anketime dhe studime në përputhje me standardet ndërkombëtare, ku të përfshihen edhe gratë me aftësi të kufizuara si të intervistuar, pjesëmarrëse, dhe si mbledhëse të të dhënave, për të siguruar që të pasqyrohen edhe pikëpamjet e tyre.

Fuqizimi i grave me aftësi të kufizuara: Të angazhohen aktivisht gratë me aftësi të kufizuara në proceset vendimmarrëse që lidhen me dhunën ndaj grave dhe organizatat mbështetëse që drejtohen prej tyre, me qëllim që të fuqizohet zëri i tyre dhe t'u kushtohet më shumë vëmendje pikëpamjeve të tyre. Të forcohet pavarësia e tyre përmes rritjes së kapaciteteve të tyre për të marrë vendime të bazuara në informacion dhe për të bërë punë avokuese për të drejtat e tyre. T'u jepet prioritet programeve për fuqizimin ekonomik të grave me aftësi të kufizuara,

të cilat janë të planifikuara posaçërisht për to, duke përfshirë trajnime profesionale dhe nisma punësimi, për të zvogëluar varësinë dhe për të lehtësuar cenueshmëritë ndaj dhunës dhe abuzimit ekonomik.

Përfshirja e komunitetit: Të shtohen nismat për përfshirjen e komunitetit që promovojnë përfshirjen dhe mbështetjen e grave me aftësi të kufizuara. Të inkurajohet pjesëmarrja vendore në përpjekjet ndërgjegjësuese dhe parandaluese, për krijimin e një mjedisi më përkrahës, për të sfiduar stigmën në shoqëri dhe për të krijuar rrjete mbështetjeje që mund të parandalojnë dhunën dhe abuzimin. Të zhvillohet dhe të forcohet edukimi i prindërve dhe familjeve, për shembull nëpërmjet nismave që fokusohen në prindërimin e mirë.

Promovimi i barazisë gjinore: Të integrohen nismat e barazisë gjinore në të gjitha politikatat dhe programet përkatëse, sidomos për trajtimin e sfidave unike me të cilat përballen gratë me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur krijimin e një shoqërie të drejtë dhe të barabartë.

Disponueshmëria dhe aksesin në shërbimet mbështetëse: Të krijohet dhe të funksionojë në vijimësi një rrjet i shërbimeve mbështetëse posaçërisht për trajtimin e dhunës, në lidhje me gratë me aftësi të kufizuara, duke siguruar që këto shërbime të jenë gjithëpërfshirëse, me personel dhe fonde të mjaftueshme për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme. Të zhvillohen dhe strukturohen shërbime të reagimit emergjent për të adresuar kërkesat unike të grave me aftësi të kufizuara, duke garantuar kështu sigurinë e tyre në kohë krize dhe duke lehtësuar aksesin në ndihmë të shpejtë.

Aksesueshmëria: Të sigurohet që të gjitha shërbimet publike dhe private që trajtojnë problemin e dhunës ndaj grave të jenë plotësisht të aksesueshme nga gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, si fizikisht ashtu edhe digjitalisht. Të zbatohen parimet e dizajnit universal për të krijuar mjedise përfshirëse dhe të sigurohet që hapësirat publike të jenë të pajisura për t'iu përgjigjur nevojave specifike të tyre, duke forcuar kështu sigurinë dhe mbështetjen për të mbijetuarat. Të zbatohet parimi i akomodimit të arsyeshëm kurdo që është e mundur, për të plotësuar nevojat e grave me aftësi të kufizuara të ndryshme, përfshirë akomodimin procedural në lidhje me aksesin në drejtësi të grave me aftësi të kufizuara. Të përdoret teknologjia për të përmirësuar aksesueshmërinë për gratë me aftësi të kufizuara, duke krijuar mekanizma raportimi të aksesueshëm për rastet e dhunës dhe duke zhvilluar mjete digjitale për arsimimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit.

Fondi Social i Punësimit: Të shfrytëzohet Fondi Social i Punësimit dhe projekte të tjera të ngjashme për të forcuar përfshirjen sociale dhe në punësim të personave me aftësi të kufizuara. Të vihet fokusi mbi zbatimin e modeleve ekzistuese të shërbimeve të punësimit dhe të zhvillimit të aftësive në nivel vendor, duke u kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave me aftësi të kufizuara.

Monitorimi dhe vlerësimi: Të krijohen mekanizmat e duhur për monitorimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve, si dhe të përfshihen gratë me aftësi të kufizuara në procesin e vlerësimit të zbatimit dhe ndikimit të ligjeve dhe programeve që lidhen me dhunën dhe diskriminimin, për të siguruar llogaridhënien dhe vlerësimin në vijimësi të përparimit të bërë.

Rekomandimet e mësipërme rezonojnë fuqishëm me ato të propozuara në Raportin e Aftësisë së Kufizuar dhe Zhvillimit (DDR) 2024, veçanërisht në thirrjen për shërbime publike të aksesueshme, sisteme të forta të mbledhjes së të dhënave dhe korniza politikash gjithëpërfshirëse. Si DDR ashtu edhe ky dokument theksojnë nevojën për të patur ofruese/ofrues shërbimesh të trajnuar posaçërisht dhe programe që synojnë sfidat unike me të cilat mund të përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Këto rekomandime të përafuara demonstrojnë një angazhim të përbashkët për ta bërë shoqërinë tonë më të sigurt dhe më gjithëpërfshirëse për të gjitha/gjithë.

Shtojcë: Koncepte kryesore: Aftësitë e kufizuara, gjinia, moshimi dhe përkatësia e shumëfishtë

Personat me aftësi të kufizuara: Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë probleme afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore që, në ndërveprim me pengesa të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri mbi baza të barabarta me të tjerët.³⁶ Në këtë grup bëjnë pjesë njerëz të

³⁶ Neni 1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK e OKB-së).

ndryshëm, përvojat e të cilëve formohen nga pabarazi të shkaktuara si rezultat i përkatësive të tyre të shumëfishta, që lidhen me gjininë, racën, përkatësinë etnike dhe moshën.³⁷ Përtej përmasave mjekësore, aftësia e kufizuar kuptohet si 'ndikimi social i ndërveprimit midis aftësisë së kufizuar individuale dhe faktorëve të mjedisit social dhe material'.³⁸

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përballen me barriera të shumta në realizimin e të drejtave të tyre: probleme të aksesueshmërisë mjedisore, fizike dhe në informacion, përfshirë mungesën e burimeve dhe aksesin e pamjaftueshëm në shërbime, si edhe diskriminim, stereotipizim dhe stigmë shoqërore mjaft të përhapur. Ato shpesh përjetojnë forma të shumëfishta diskriminimi për shkak të faktorëve të tjerë përveç atyre të gjinisë dhe të aftësisë së kufizuar.³⁹ Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara mund të jenë shumë të izoluar kur ndodh dhuna, që ua bën edhe më të vështirë t'i shpëtojnë abuzimit dhe ta denoncojnë atë. Stigma dhe diskriminimi mund të zvogëlojnë më tej aksesin në shërbime dhe informacion, ose të bëjnë që dëshmitë e tyre për dhunën e pësuar të mos merren seriozisht.⁴⁰

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara intelektuale kanë aftësi mjaft të zvogëluar për të kuptuar informacione të reja ose të ndërlukuara dhe për të mësuar dhe ushtruar shprehje të reja (inteligjencë të cinguar), me aftësi të kufizuar për t'i përballuar situatat në mënyrë të pavarur (funksionim social i cinguar) që u ka filluar para moshës madhore dhe ka ndikim afatgjatë në zhvillimin e tyre.⁴¹ Ato kanë shumë pak kontroll mbi jetën e tyre. Mungesa e aksesit në informacion mund të bëjë që të vazhdojnë qëndrimet negative dhe konceptet e gabuara për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara intelektuale. Krahas kësaj, për shkak të kufizimeve në aftësitë njihëse, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara intelektuale janë më të cenueshme nga rreziqe si shfrytëzimi seksual, shtatzaninë e padëshiruara dhe infeksionet e transmetuara në rrugë seksuale.⁴²

Gratë dhe vajzat me çrregullime mendore kanë çrregullime të konsiderueshme në aftësitë njihëse, rregullimin e reageimeve emocionale ose në sjellje, që u shkakton gjendje të dëshpëruar dhe funksionim të cinguar.⁴³ Çrregullimet si ankthi, depresioni, çrregullimi bipolar dhe ÇSPT (çrregullimi i stresit post-traumatik) shpesh përkeqësohen nga vështirësitë specifike gjinore, ndër të cilat edhe stigma shoqërore dhe aksesin e kufizuar në përkujdes. Gratë ndikohen në mënyrë disproporcionale nga disa probleme të shëndetit mendor gjatë ndryshimeve hormonale që lidhen me pubertetin, shtatzaninë dhe menopauzën. Kjo ndërthurje midis shëndetit mendor dhe gjinisë shton cenueshmërinë e tyre dhe rrit ndikimin e stigmës dhe diskriminimit, duke çuar shpesh në trajtim të pamjaftueshëm dhe shkelje të të drejtave të tyre.

Gratë e moshuara me aftësi të kufizuara përballen me forma të ndërthurura të diskriminimit, paragjykitimit dhe marginalizimit, dhe sistematikisht nuk merren në konsideratë dhe janë të nënpërfaqësuar në politika, programe, nisma, legjislacion dhe në përpjekje humanitare. Varësia e tyre nga anëtarët/anëtarët e familjes për mbijetesë dhe përkujdes të përditshëm i bën veçanërisht të cenueshme, përfshirë edhe ndaj abuzimit. Për këtë arsye, aksesin në mbrojtje sociale i grave të moshuara me aftësi të kufizuara është me rëndësi kritike. Ato përballen me ligje diskriminuese, mohim të mundësisë për të kërkuar të drejtën në gjykatë dhe me institucionalizim, si dhe janë veçanërisht të rrezikuara që të preken së tepërmi nga krizat.⁴⁴ Rolet dhe pritshmëritë gjinore shpesh bëjnë që këto

³⁷ UN Women. 2020. "Discussion paper: sexual harassment against women with disabilities in the world of work and on campus" (Dokument për diskutim: ngacmimi seksual i grave me aftësi të kufizuara në botën e punës dhe në universitete).

<https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Library/Publications/2020/Discussion-paper-Sexual-harassment-against-women-with-disabilities-en.pdf>

³⁸ UN Women. 2017. "Issue brief: Making the SDGs count for women and girl with disabilities" (Dosje tematike: Vënia e OZHQ-ve në shërbim të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara). <https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Library/Publications/2017/Making-SDGs-count-for-women-with-disabilities.pdf>

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Organizata Botërore e Shëndetësisë. 2024. "WHO calls for greater attention to violence against women with disabilities and older women" (OBSh-ja bën thirrje për më shumë vëmendje ndaj dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara dhe grave më të moshuara). <https://www.who.int/news/item/27-03-2024-who-calls-for-greater-attention-to-violence-against-women-with-disabilities-and-older-women>

⁴¹ OBSh (në internet). *Key terms and definitions in mental health* (Terma kyçe dhe përkufizime në fushën e shëndetit mendor).

<https://www.who.int/southeastasia/health-topics/mental-health/key-terms-and-definitions-in-mental-health#mental>

⁴² National Library of Medicine (në internet). 2021. "Sexual health concerns in women with intellectual disabilities: a systematic review in qualitative studies" (Shqetësime të shëndetit mendor tek gratë me aftësi të kufizuara intelektuale: një shqyrtim sistematik studimesh të të dhënave cilësore).

<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC8556840/>

⁴³ OBSh 2022 (në internet). "Mental disorders" (Çrregullimet mendore). <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/mental-disorders>

⁴⁴ UN Women. 2022. "Gender, age, and disability: Addressing the intersection" (Gjinia, moshë dhe aftësia e kufizuar: trajtimi i përkatësisë së shumëfishtë). <https://unwomen.org/sites/default/files/2022-06/Brief-Gender-age-and-disability-en.pdf>

gra të detyrohen të jetojnë në varësi ekonomike. Si rezultat, gratë e moshuara me aftësi të kufizuara janë shumë më të varfra. Gratë e moshuara me aftësi të kufizuara që i kanë mbijetuar dhunës seksuale përballen me pengesa të veçanta për sa i përket mundësisë për të treguar përvojat e tyre dhe aksesit në drejtësi, duke bërë që përvojat e tyre të mbeten të fshehura.⁴⁵

Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar do të thotë çdo dallim, përjashtim ose kufizim për shkak të aftësisë së kufizuar, qëllimi ose rezultati i të cilit është dëmtimi apo mohimi i njohjes, gëzimit, ose ushtrimit, njësoj si të tjerët, i të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile, apo çdo fushë tjetër. Ai përfshin të gjitha format e diskriminimit, përfshirë mohimin e akomodimit të arsyeshëm.⁴⁶

Dhuna ndaj grave përkufizohet si “çdo akt dhune me bazë gjinore që rezulton, ose ka gjasa të rezultojë, në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, ose mendore të grave, përfshirë edhe kërcënimet për kryerje të këtyre akteve, shtrëngimi ose heqja arbitrare e lirisë, qoftë kur ndodh në jetën publike, ashtu edhe në atë private.”⁴⁷

Përkatësia e shumëfishtë është një term që përdoret për të përshkruar konceptin se në marrëdhëniet sociale ka një numër formash të shumëfishta diskriminimi. Kjo do të thotë se një person mund të përjetojë disa forma diskriminimi, për shkak të seksit, racës, ose aftësisë – që të gjitha në të njëjtën kohë. Për shembull, një grua rome mund të përjetojë diskriminim qoftë për shkak të gjinisë, ashtu edhe për shkak të përkatësisë etnike të saj. Përkatësia e shumëfishtë është e rëndësishme në kuadër të barazisë gjinore, sepse na ndihmon të kuptojmë se si ndërveprojnë dhe se si e përkeqësojnë pabarazinë format e ndryshme të diskriminimit.⁴⁸

⁴⁵ Raport i raportuesit special mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. 2019. https://ngocooa-ny.org/recent-documents-of-interest/a_74_186_sr-on-pwd-incl.pdf

⁴⁶ Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 2. <https://social.desa.un.org/issues/disability/crpd/convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities-articles>

⁴⁷ Kombet e Bashkuara. 1993. Deklarata për eliminimin e dhunës ndaj grave. https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocities-crimes/Doc.21_declaration%20elimination%20vaw.pdf

⁴⁸ S. Nedera. 2023. <https://www.undp.org/bosnia-herzegovina/blog/what-intersectionality-and-why-it-important-gender-equality>